



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Nr. 52

Datë: 18. 08. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvij, Rifat Krasniq dhe Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misni; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr. 50 dhe 51/2021
3. Aktivitetet e SKQZ-së
4. Aktivitetet e ZRPPC-së:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike,
5. Këshillat e KQZ-së:

- Këshillit për Operacione Zgjedhore:

-Shqyrtimi dhe miratimi i realizimit të raportit të Planit të Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Janar – Qershor 2021,

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për refuzimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës, të pranuar nga shteti i Malit të Zi.

- Këshilli për Buxhet dhe Financa:

-Shqyrtimi dhe miratimi i pagesës për A-Web,

-Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit të koeficienteve të zyrtarëve të TI në QNR,

-Shqyrtimi dhe miratimi i pagesave për stafin të cilët janë larguar nga lista për pagesë por kanë qenë të angazhuar në proces të zgjedhjeve parlamentare 14 shkurt 2021,

- Këshilli për Çështje Ligjore

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut,

-Shqyrtimi i miratimi i Udhëzimit Administrativ për Stafin teknik në QV,

- Këshilli për Personel

-Vlerësimi vjetor i punës dhe detyrave të Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së dhe ZV të KE-së.

6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik

7. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KOZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Përshëndetje për të gjithë, po e fillojmë mbledhjen e 52-të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sot mungojnë dy anëtarë: z. Sami Kurteshaj dhe z.Fazli Stollaj të cilët,

kanë lajmëruar se nuk mund të marrin pjesë në këtë mbledhje. Anëtarët e tjerë janë të gjithë prezent, para vetes e kemi rendin e ditës të propozuar.

Pasi që kryetari z. Radoniqi, prezantoi pikat e agjendës së mbledhjes i pyeti anëtarët e KQZ –së se, a kanë ndonjë propozim, pyetje etj.

Arianit Elshani: Faleminderit shumë kryesues, Këshilli për Operacione Zgjedhore kërkon që shqyrtimi dhe miratimi i realizimit të raportit të planit të punës së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve janë qershor të bartet për mbledhjen e ardhëshme me qenë se nuk kemi arritur që të shqyrtojmë dhe të miratojmë në parim. Faleminderit.

Gordana Zuviq: Takimi Këshillit Mbikqyrës për Informim publik nuk është mbajtur, sepse e kemi lënë mbas mbledhjes. Bëhet fjalë për pikën e gjashtë...

Alim Rama: Po ashtu, nga këshilli për buxhet ne nuk e kemi miratuar shqyrtimin për pagesa për aëeb. Këtë, e kemi e kemi referuar të këshilli për marrëdhënie me jashtë. Te pika e dytë, shqyrtimin dhe miratimin për refuzimin e aplikacioneve duhet me u riformulu se nuk është sikurse se që është këtu, dhe ne kemi kërkuar riformulimin...

Florian Dushi: Mendoj se mbasi edhe Gordana është këtu si kryesuese, procesi i pagesës sa përket aweb-it, ne e kemi vendosur që të jetë rekomandim, të prezantohet sikur rekomandim i Këshillit për Buxhet dhe Financa dhe të bartet të Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë...Do të thotë, të Këshilli i Buxhetit pika e parë hiqet prej rendit të ditës, sepse shkon në Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë, pastaj vjen në KQZ..

Kreshnik Radoniqi: E qartë, e qartë...

Arianti Elshani: Edhe rregullorja e brendshme e KQZ-së e parasheh se kemi dhe mbajmë mbledhje me kryesuesit e këshillave, ku pastaj përcaktohet edhe agjenda edhe rendi i ditës dhe këtë realisht, nuk jemi duke e praktiku dhe ndoshta, është ai formati aty ku delegohen këto çështje, andaj nuk po besoj që parimisht duhet ta vendosim si pikë të rendit të ditës rekomandimin për bartje në një këshill tjetër, ky është qëndrimi, faleminderit...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, agjendën e kemi me ndryshim: të hiqet pika e parë e operacioneve zgjedhore për planin e punës, e kemi njoftimin për Këshillin Mbikqyrës të hiqet edhe kjo pikë njoftimi...

Gordana Zuvij: Në takim ne kemi diskutuar dhe pasi që nuk kemi rënë në ujdi, jemi dakorduar që të shkojë si rekomandim...sepse, është bërë debat se a jemi ne kompetentë për të vendosur, apo nuk jemi... Dhe, kemi vendosur që ta sjellim në KQZ që të diskutohet s'i propozim dhe të vendoset...

Yll Buleshkaj: Nëse më lejohet. Nën pikën e pikës 4, ta shtyjmë për mbledhjen e ardhshme...

Kreshnik Ryesuesi: Atëherë, kush është këtë rend dite edhe me heqjen e pikës: “Certifikimi i subjekteve politike...”, dhe heqjen e dy pikave tjera...?

Miratohet rendi i ditës.

Në vazhdim, miratohen procesverbalet nr. 50 dhe 51/2021 të mbledhjeve të KQZ.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së

Burim Ahmetaj: Sekretariati është duke i bërë përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve që do të mbahen me 17 tetor 2021, aktualisht janë dy periudha të cilat janë në proces e sipër, është fjala për periudhën e ndërrimit të qendrave të votimit, periudhë e cila ka fillu me 20 korrik dhe raporti është i datës 17 gusht në orën 20:00 ku qytetarët përmes platformës online në webfaqen e KQZ-së, kanë shfrytëzuar mundësinë e ndërrimit të qendrave të votimit dhe deri tani kanë parashtruar kërkesë për ndërrimin e qendrave të votimit 2670 kërkesa, pra përmes platformës online.

Ndërsa duke iu referuar raportit 20 korrik deri me 13 gusht 2021, në zyrat e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve janë parashtruar 300 kërkesa për ndërrimin e qendrave të votimit përmes formularëve të aplikimit, pra deri me tani qytetarët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për të ndryshuar qendrat e votimit, në numër prej 2970 kërkesa, ndërsa periudha tjetër e cila ka filluar me 10 korrik e cila pritet të mbyllet sot në orën 24:00 pra para mesnatës është periudha e aplikimit për votuesit jashtë vendit, pra jashtë Kosovës pra raporti është i datës 17 gusht të orës 20:00 dhe deri në atë periudhë kanë aplikuar 10.638 aplikime pra për tu regjistruar si votues jashtë vendit, të gjitha këto aplikime janë përmes emailit, në emailt zyrtarë të cilat i ka publikuar KQZ, pra nga 10.638 aplikacione të pranuar për regjistrim prej tyre 9652 aplikacione janë të aprovuara, Sekretariati edhe sot do të vazhdojë me pranimin e aplikacioneve deri në mesnatë pra të ditës së sotme të datës 18 gusht dhe do të trajtojë të gjitha kërkesat po ashtu në koordinim edhe me Asgjësonin e Regjistrimit Civil do të i

marr te gjitha veprimet e duhura me qëllime te verifikimit te saktë te secilit votues ne përputhje me procedurat.

Ndërsa, në kuadër të aktiviteteve të tjera për organizimin e zgjedhjeve KQZ-ja, është duke e vazhduar vizitat neper komisionet komunale te zgjedhjeve në secilën komunë me datën 13 gusht janë realizuar vizitat në komunat Hani i Elezit, Kaçanik dhe Shtërpçë ku kane qenë përfaqësues edhe te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, kërkesat ndryshojnë nga komuna ne komunë ku një nder çështjet e cila është diskutuar me se shumti në komunën e Hanit te Elezit, po ashtu edhe në komunën e Kaçanikut ka qenë e ndërlidhur me të drejtën e votuesve për të votuar ne ditën e zgjedhjeve meqenëse Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë Veriut e mban zgjedhjet ne te njëjtën dite edhe kemi një numër te qytetareve te cilët janë votues te dy shteteve, pra ne te njëjtën ditë qytetarët munden te shfrytëzojnë të votojnë edhe ne zgjedhjet lokale në Kosovë po ashtu edhe te drejtën e tyre edhe në Republikën e Maqedonisë se Veriut.

Pra, tha z. Ahmetaj, sipas atyre diskutimeve që u bënë në këto dy komuna diku rezulton një numër i konsiderueshëm i qytetareve te cilët kanë dy nënshtetësi edhe te cilët mund të shfrytëzojnë te drejtën e votimit në këto dy shtete. Mirëpo, do të shikojmë edhe për hapat e mëtejme se çfarë hapash do te marrë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në raport me trajtimin e gjithë këtyre votuesve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po ashtu ne kuadër te përgatitjeve te zgjedhjeve është në procedura te ndryshimeve procedurale pra pas miratimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve te procedurat te numërimit dhe te paketimit tash me është ne fazën e draftimit te doracakut te trajnimit për procedurat e trajnimit dhe numërimit dhe po ashtu ne te njëjtën kohë reflektojnë këto në ndryshime dhe në procedurat e Qendrës se Numërimit dhe Rezultateve.

Pra, të gjitha këto ndryshime procedurale ndërlidhen me procesin e votimit te fletëvotimeve për kandidatët sidomos për fletat llogaritëse te kandidatëve plotësimit te librit te votimit ku të gjithë votuesit duhet te shënojnë edhe arsyen se pse do te asistojnë apo do të nevojitet asistencë gjatë ditës së votimit për të gjithë ata votues si dhe procedurat e paketimit që ne kutitë e votimit me nuk mund te jene uvsprej dhe uvlambat por do te trajtohen sikur material administrativ te cilët do te përcillen me tutje ne KKZ. Pra te gjitha këto do te inkorporohen ne doracakun e trajnimit për procedurat e votimit dhe numërimit dhe procedurat e Qendrës se Numërimit konform vendimeve nga KQZ. Pra ne pika te shkurta keni edhe pjesë të tjera të raportit por ne pika te shkurta këto janë aktivitetet kryesore që sekretariati është duke i zhvilluar deri më tani.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka, lidhur me raportin e z. Ahmetaj ? Nëse jo, vazhdojmë me aktivitetet e ZRPPC-së...!

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike:

Ylli Buleshkaj : Faleminderit shumë i nderuar kryetar të nderuar anëtarë, e keni para jush një raport te shkurtë nga procesi i aplikimit për çertifikime të partive politike numrat janë ashtu siç janë aty por janë numra te përkohshëm sepse mundet të ketë iniciativa apo qofte edhe parti politike te cilat mundet te tërhiqen apo mundet te tërhiqen edhe kandidatët, kështu qe numrat janë të përkohshëm ashtu siç kanë aplikuar deri më tani. Ashtu siç e dini kanë aplikuar 94 subjekte politike nga ato 32 jane parti politike, 1 koalicion, 35 iniciativa qytetare dhe 26 kandidate te pavarur më së shumti ka subjekte politike që vine nga komuniteti shqiptare me 16 parti me 21 iniciativa, 18 kandidate te pavarur, pastaj vjen komuniteti serb me një parti politike 7 iniciativa qytetare dhe 7 kandidatë të pavarur. Komuniteti turk me 3 parti politike, 1 iniciativë qytetare dhe 1 kandidat i pavarur. Komuniteti boshnjak me 3 parti politike, 1 koalicion dhe 3 iniciativa qytetare. Komuniteti goran me 3 parti politike. Komuniteti rom me 1 parti politike dhe 1 initiative qytetare.

Komuniteti egjiptian me 2 parti politike. Komuniteti hashkali me 2 parti politike, 1 initiative qytetare edhe iniciativa te përbashkëta te cilat janë qoftë shqiptare apo boshnjake një iniciativë qytetare në mes të komuniteteve egjiptian dhe hashkali. Ajo që është ndoshta e rëndësishme të ceket ka komuna te cilat duket që do te ketë konkurrencë me të madhe për ulësen e kryetarit te komunës dhe ato sipas dhënave te tanishme janë komuna e Pejës dhe Prizrenit me nga 9 kandidatë ndërsa të dy këto komuna e kanë nga 14 dhe 12 subjekte politike te cilat kane treguar interesa për të garuar për ulëset për kuvende komunale të tyre pra konkurrenca më e madhe në Kosovë duket që të jetë në këto dy komuna edhe pse Prishtina është kryeqytet edhe ka numrin më të madh të ulëseve në kuvende komunale pastaj edhe në komunat qe ka me pak interesa kushtimisht ta themi për ulësen e kryetar të komunës është Vitia, Hani i Elezit dhe Hanirlluku me nga dy aplikacione si dhe komunat tjera për kuvende komunale qe kanë pak interes është komuna e Hanirllukut që është me dy subjekte politike te cilat garojnë për këto ulëse në këto kuvende komunale, prapa e kemi edhe tabelën ashtu siç është nxirrë nga formularët e aplikimit të numrit të subjekteve politike qoftë që aplikojnë për

kryetare te komunave po ashtu edhe për Kuvend Komunal vetëm kush donë që ka interes në aspektin statistikor.

Jemi në shqyrtim, tha z. Buleshkaj edhe të aplikacioneve te pranuar 99% te subjekteve politike qe kanë aplikuar kanë pranuar tashmë shkresa nga ne për plotësimet e nevojshme te cilat është dhëne edhe afati për të dorëzuar këto plotësime. Janë mbi 90% qe kanë pasur nevojë te pranojnë shkresa nga zyra për plotësime. Në qoftë se keni ndonjë pyetje ?

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka ?

Florian Dushi: Faleminderit kryesues, dëshirova me u ndërlidh me këtë pjesën e fundit që ka të bëjë me shkresat që janë dërguar partive politike dhe kërkesat e ligjshme natyrisht të zyrës qe ka pasur drejtuar partive politike për të bërë korrigjimet e nevojshme ka një çështje për të cilën jemi marr vesh jemi pajtuar me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që nuk ndërlidhet fortë me ne por, megjithatë që na ka shtyrë në njëfarë forme të bëjmë një zgjidhje për shkak të problemeve që qytetarët në Kosovë e kanë në përgjithësi e në këtë fazë kandidatët tanë me sigurimin e letërnjoftimeve. Praktikisht, ka një numër të madh te kandidateve te cilët kane bërë aplikimet të tyre për letërnjoftime kanë bere ndërrimin e vendbanimit ashtu siç, edhe kërkohet edhe me ligjin për zgjedhjet lokale por megjithatë për shkak që nuk janë pajisur me letërnjoftim ata edhe nuk e kemi në ekstraktin te cilin e kemi tani aktualisht sipas kërkesave që ata e kanë bërë pra këtu mundet me pas diçka qe na sjell një tip konfuzioni ne e kemi sjell kërkesat subjektit politike LDK-se janë bërë kërkesat edhe është thënë deri me datën 19 duhet me i sjellë korrigjimet.

Në anën tjetër, tha z. Dushi, nëse ne kemi thënë që do të referohemi dhe do ta kemi databazën e ARC-së me kërkesat e aprovuara për ndërrim vendbanimi të reflektuara në ekstraktin që do ta marrin te regjistrin civil e cilin do ta marrim me datën 20-të qe i bien një ditë pas afatit te caktuar të një subjekti politik por besoj edhe shumë tjerave sepse dimë që afatet janë përafërsisht dy ditore mendoj që ndoshta do të ishte mirë që subjektet politike të jepet afate së paku deri kur institucioni jonë do ta ketë ekstraktin e ri te regjistrin civil nga Agjencia për Regjistrimin Civil i cili, ashtu siç jemi merr vesh dhe ashtu se siç na është thënë, do të reflektoj ose në cilin do te reflektojnë në kërkesat e qytetareve, kandidatëve në këtë fazë për të u pajisur me letërnjoftime sipas vendbanimit të tyre që thjeshtë, të mos kemi kërkesa për të zëvendësuar ndonjë kandidat i cili, nuk e mbush

kriteret që kërkohet të jetë kandidatë... Dhe, njëkohësisht votues në komunën e njëjtë në këtë fazë, sipas ekstraktit të vjetër ndërsa me ekstraktin e ri...Do të kemi edhe votues edhe kandidatë në të njëjtin subjekt politike prandaj, vetëm se dëshirova me ju sqarua me ju përkujtuar dhe me kërkuar nga zyra qe eventualisht pa fajin e saj kuptohet te shoh se si mundet me organizuar këtë provës te korrigjimeve kisha me thanë në përputhje me afatin të cilin, ne do ta pranojmë ekstraktin e ri të regjistrimit civil...

Ylli Buleshkaj: Faleminderit pyetja është shumë me vend sepse kemi shumë raste te cilat votuesit kanë tani kandidate kanë aplikuar në komunat te cilat janë transferuar po për shkak të mungesës se dokumenteve nuk kanë arrit që ato të prodhohen edhe pastaj te zhvendosen. Kjo, sigurisht që nuk do të ishte dashtë me pengu procesin këto dokumentacione në qoftese janë nxjerre apo në qoftëse është aplikuar për ndërrime të komunës i njëjti informacion mundet të bartet te zyra në mënyre që të kemi parasysh kandidatët e caktuar që pritet me ekstraktin e ri të barten në komunën... Kemi disa raste edhe ku kanë marrë letërnjoftimet por ndërkohë nuk kanë reflektuar në listë kemi diku 10 nga këta pesëmijë por kemi edhe raste te cilët nuk kanë aplikuar fare për ta ndrru sepse kemi një konfuzion te vogël besoj në mesin e kandidateve qe kanë besua me ndërrimin e adresës të regjistrimit civil po mos ndërrim të letërnjoftimit ,do te barten në komunën tjetër por ajo nuk ndodh se ne marrim ekstratin nga prodhimi i dokumenteve, kemi edhe këtu te paktën nja pesë raste qe i kemi vërejte, qe nuk kane apliku e ato janë me problematike ndërsa këto qe kanë dokument ose te paktën qe kanë apliku para certifikimit për ndërrim po besoj qe ato kanë mu zgjedh shumë shpejtë.

Kemi bërë kërkesë te Divizioni i Listës Votuese qe ta merr ekstratin më herët e që i bjen para të 20 - tit, jo më vonë se 19 në mënyrë që të adresohen këto e të mos vonohet askush qoftë ne me dorëzimin e kërkesave për verifikim të institucioneve të jashtme qoftë dhe subjektet politike me plotësimin në qoftëse është e nevojshme që të plotësohen kështu që po besoj se, kemi bërë një zgjidhje të mirë dhe të pranueshme që askush të mos ta humb të drejtën që i takon...

Alim Rama: Kryesues, unë mendoj se ne kemi marre një vendimin edhe po mu duket që në parim janë pajtua që certifikata ose dokumenti që dëshmon që kandidati që ka ndërrua vendvotim që të aprovet në këtë fazë fillestare ndërkohë lëshojnë ato letërnjoftimin dhe unë nuk po e shoh problemin ne vonesën sepse mendoj se procesi duhet me vazhdu edhe te gjithë ata qe kane apliku për ndryshim të vendvotimit për një letërnjoftim në komunën tjetër deri me datën kur ka qenë 16-ti, atëherë për mua është në rregull...

Arianit Elshani: Një gjë që është e rëndësishme që e përmendi drejtori, është çështja që mund të ketë kandidatë apo qytetarë të cilët kanë ndërruar vendbanimin por nuk kanë aplikuar për ndryshim të letërnjoftimit dhe pa këtë kërkesë ata mund të ndërrojnë qendrën e votimit por edhe privohen nga e drejta për të kandiduar apo për të zgjedhur në një komunë tjetër ku aplikon për letërnjoftim. Kjo besoj që është e rëndësishme për qytetarët dhe për të gjithë ata kandidatë, po e përsëris pak me qëllimin që të informohet edhe publiku që ky është parimi mbi të cilin ne krijojmë listën votuese, mbi të cilën neve na dërgon ekstraktin dhe databazën e gjithë listës votuese ARC-ja Agjensioni i Regjistrimit Civil, kështu që pa këtë, është mirë që edhe subjektet politike të informohen lidhur me këtë çështje meqenëse mund të kenë menduar që me ndryshimin e vendbanimit kanë të drejtë edhe garimin në një komunë tjetër....

Krshenik Radoniqi: Po më duket që është e qartë... Vazhdojmë me agjendën...!

4. Këshillat e KQZ-së:

1.Këshillat për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për refuzimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës, të pranuar nga shteti i Malit të Zi:

Arianit Elshani: S'i pikë e rendit të ditës nga Këshilli për Operacione Zgjedhore është trajtuar shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për refuzimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës nga domene të dyshimta gjatë kësaj periudhe zgjedhore të regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, janë evidentuar disa raste, një numër prej 800 personave prej 800 emaileve të cilët janë dorëzuar në KQZ përmes email adresave të cilët për KQZ janë të dyshimta, nuk janë kredibile dhe janë një tendencë ndoshta për manipulimin e zgjedhjeve. Këto ne i kemi trajtuar bashkarisht me të gjithë anëtarët dhe, kemi rënë në konstatim se pas kontaktimit të 89 aplikacioneve të 89 personave vetëm tre prej tyre kanë konfirmuar identitetin e tyre, ndërsa të tjerët nuk janë përgjigjur, nuk kanë punuar numrat e tyre, kanë qenë jofunksionale dhe ne kemi konstatuar se të gjitha ato raste duhet të procedohen për hetim. Pra, jo vetëm 89 por në total prej 800 aplikacioneve të cilët kanë ardhur, për shkak të konfidencialitetit dhe nevojës që hetuesia të merret me këtë çështje.

Kërkoj edhe nga ju, tha z. Elshani që domenet të cilat i keni te përfshira në këtë raport të jenë besoj konfidenciale dhe të mos të bëhen të njohura për publikun por të dorëzohet kjo dosje dhe ky material prej gjithsej 800 aplikacioneve në hetuesi, cka ka arritur të evidentojë KQZ-ja deri më tani është që një numër i madh i këtyre aplikacioneve kanë qenë pjesë e listës votuese të komunës së Istogut, ashtu siç ka ndodhur pra ne e kemi një referencë në të kaluarën ku ka ndodhur në vitin 2017, është konstatuar po ashtu edhe nga KQZ-ja edhe nga PZAP-i edhe nga gjykata se disa persona të cilët është aplikuar në emër të disa personave, këtë rekomandim e keni duke u bazuar edhe në udhëzimin administrativ të miratuar në KQZ lidhur me kontaktimin e një mostre të gjitha aplikacioneve që pranohen në KQZ. Po ashtu, janë edhe rreth 168 aplikacione të tjera të cilat janë kontaktuar brenda kësaj, brenda 800-shit, të cilët janë kontaktuar vetëm një herë ndërsa 89 aplikues janë kontaktuar nga 3 herë andaj ne konstatojmë që këto aplikacione duhet të drejtohen drejtë në hetuesi nga organet e hetuesisë dhe ata të merren me këtë çështje kështu që rekomandojmë si Këshill bashkërisht që të miratohet ky rekomandim dhe këta persona të mos përfshihen në listën votuese të votuesve jashtë vendit.

Florian Dushi: Faleminderit kryesues ,e para ne nuk e kemi këtë raport, ndoshta kjo ka qenë në Këshillin për Operacione Zgjedhore, tash është problem me gjithë këto letra me i gjetë. Mirë e gjeta, por ajo që është me rëndësi të theksohet ndoshta këtu është që nga informoj Sekretariati për mënyrën se si do ta procedojë këtë çështje në hetuesi sepse në të vërtetë nëse një problemi nuk po i qasemi seriozisht kjo vjen dhe na përsëritet, u përmend rasti i Istogut në vitin 2017 dhe unë po du me potencu që përkundër vendimit të PZAP dhe përkundër referimit të çështjes në atë kohë nga Paneli në Prokurorinë e Shtetit, unë di që kanë nisur një proces në prokurori por nuk di që është përmyll ndonjëherë, prandaj vijmë edhe në vitin 2021 na përsëritet e njëjta situatë nga i njëjti shtet Mali i Zi dhe për të njëjtën komunë Istogun prandaj unë kërkoj që ne si institucion përveç, referimit të çështjeve, meqë kemi përgjegjësi primare organizimin dhe ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor të vejmë kontakte edhe me organet e ndjekjes, jo për të ndërhy në një formë në proces por thjeshtë për ti lutur ata me mirëkuptim që rastet nga proceset elektorale të trajtohen me prioritet për shkak se zgjedhjet sidomos në vendin tonë po kemi shpesh dhe të njëjtat raste të manipulimit ose të tendencës për të manipuluar me procesin po na përsëriten sërish në zgjedhjet vijuese. Prandaj unë kërkoj që edhe ky rast ti referohet prokurorisë dhe sidomos prokuroria të njoftohet për

ngjashmëritë që ka me procesin e manipulimit që është zhvilluar por për fat të mirë ndaluar nga organet në atë kohë në komunën e Istogut, për të bërë ndërlidhjet eventuale edhe me atë proces i cili mesa e di unë, është në vazhdim e sipër sepse, po e them prapë, ashtu edhe si u informuam edhe nga kryesuesi i këshillit, pra kemi të bëjmë me të njëjtën komunë dhe kemi të bëjmë me adresën prej nga vijnë këto aplikime të falsifikuara, pra me të njëjtën adresë që është shteti i Malit të Zi: jo shteti i Malit të Zi por thjeshtë, domenet të cilat vijnë prej andej...

Ilir Gashi: Faleminderit kryesues, veç u tha që kjo po përsëritet, fatkeqësisht nuk është vetëm komuna e Istogut, në kuptimin që janë aplikime nga Mali i Zi por vetë fakti që afër 50% të aplikuesve nuk votojnë nga jashtë tregon se sa i pambrojtur është votimi jashtë vendit dhe ky rast është eklatant sa i përket që 4 vite prej 2017-tes përsëritet dhe Prokuroria e Shtetit do të duhej me vepru në relacion edhe me shtetet që ka raporte sepse sot teknologjia është, nuk mund të fshehësh nëse aplikon, këto domene ekzistojnë pavarësisht nga cili shtet aplikojnë dhe është mirë që kjo të merret shumë seriozisht sepse 4 vite pas e kemi të njëjtin problem ,dhe fatkeqësisht nuk ka me qenë vetëm problemi i Malit të Zi por kemi me pa ne kur te përmbyllet i gjithë procesi i aplikimit nga

diaspora,e shohim që rastet e tilla do të përsëriten prandaj nuk do të thotë që me u marr vetëm me këtë problematikë Prokuroria e Shtetit por kur te porconializohen kur të ndahen votuesit të cilët kanë aplikuar nga shtetet veç e veç është mirë që kjo të trajtohet veç e veç nga shtetet përkatëse sepse ka ende njerëz që kanë kesi vullneti për me manipulua procesin. Faleminderit...

Alim Rama: Sigurisht që pajtohem ashtu si jam pajtu edhe në Këshill për Operacione Zgjedhore që të gjithë rastet e dyshimta të hetohen edhe unë mendoj që nuk na takon neve që medoemos me thanë që ky është procesi i ndjeshëm ose i rrezikueshëm, secili proces zgjedhor i ka ato rrezikshmëritë e veta, unë mendoj që KQZ-ja dhe Sekretariati duhet me i vendosë të gjithë elementet ose të gjithë mekanizmat që kanë në funksion për me sigurua integritetin e procesit. Unë, tha z. Rama, isha përmbajte prej asaj që paragjykim që procesi i votave me postë është i rrezikueshëm, sigurisht edhe i votave me postë i pambrojtur por setcili proces zgjedhor i ka ato rrezikshmëritë e veta kështu që derisa ne i të gjitha procedurat, është një udhëzim administrativ pavarësisht prej cilit shtet vijnë, prej cilësdo komunë që aplikojnë duhet që, puna është që Sekretariati me i identifikua këto raste na është rekomandimi që me marrë një vendim edhe që hetuesia apo cilido organ tjetër ndjekës që ka nevojë, sepse është policia kibernetike, kushdo tjetër... Por, për mu është e pakuptueshme që 4 vjet pas ende nuk kemi epilogun e

procesit, na e kemi pasur rastin e shkurtit dhe ende nuk kemi epilogun e procesit, dhe është mirë që epilogu i çdo procesi të mbrohet ashti si edhe procesi zgjedhor...

Ibrahim Selmanaj: Unë, du me e përgëzua punën e administratës që e ka bërë, edhe ky është veprim konkret dhe kemi të bëjmë me një dokument që është po ashtu konkret, po na përsëritet e njëjta situatë që ë kemi pas edhe para 4 viteve, në këtë rast një subjekt politik ka qenë i dëmtuar ose një subjekt tjetër politik do të dëmtohet tash, është momenti i fundit kur duhet Prokuroria të merret konkretisht më këto tema dhe nuk ka heshtje, heshtja është aprovim...

Kreshnik Radoniqi: Unë, po besoj që kjo do të shkoj tash në Prokurori edhe prokuroria i din punët e veta dhe i ka afatet e saj ligjore, nuk ka ndonjë obligim me na njoftu neve nëse nuk ka gjet do të thotë të gjeturat tash ne vazhdimësi nuk ka prokuroria obligim me na njoftu, poqese prokuroria gjane se kush ka ndërhyrë kur i ka bo këto atëherë ata i kanë atëherë veprimet e tyre ligjore që munden me i ndërmarrë, na nuk hyjmë në punën e prokurorisë as nuk mundemi me kërkua prej Prokurorisë me na njoftu për procedurën hetimore, e jona është me i identifiku edhe me ia referu prokurorisë dhe aq përfundon, prokuroria i din punët e veta. Unë e hedhi ne votim rekomandimin, kush është për miratimin e rekomandimit të propozuar...? Miratohet rekomandimi për refuzimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës nga emailat me adresa te dyshimta.

2.Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Shqyrtimi dhe miratimi i pagesës për Aëeb

Gordana Zuvig: Në takimin që e kemi mbajtur sot në KB, kemi analizuar dhe shqyrtuar 3 pika: 1. E para, shqyrtimi i pagesës së anëtarësisë për AËEB. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit të koeficienteve të zyrtarëve të TI në QNR. 3. Shqyrtimi i vendimit për pagesën e atyre që janë larguar nga lista e pagesave por që kanë qenë të kyqur në procesin e zgjedhjeve parlamentare të 14 shkurtit.

Pika e parë, është hequr tha znj. Gordana. Në vazhdim, ajo shpjegoi se përgjatë procesit janë planifikuar të angazhohen 12 persona me koeficient 7, mirëpo tha ajo: këtu është bërë një

gabim teknik. Në vend se të vendoset koeficienti 8, është vendosur koeficienti 7, dhe kemi kërkesë nga Sekretariati që kjo të përmirësohet. Buxhet ka, në anën tjetër është e vështirë që të kemi ekspertë të këtyllë me këtë pagesë, pra me koeficient 7 sepse, këta paguhen shumë më shumë dhe, është kërkuar që koeficienti të rritet...

Ndërkaq, në vazhdim znj. Gordana e shpjegoi në mënyrë të detajuar edhe problemin e pagesave për stafin të cilët janë larguar nga lista për pagesë por kanë qenë të angazhuar në proces të zgjedhjeve parlamentare 14 shkurt 2021.

Ilir Gashi: Sa i përket pikës së parë do të thotë buxhetit shqyrtimi i pagesës Aweb këtë po e vendosim që të kthehet në këshillin për mardhanë me jashtë dhe mendoj që nuk duhet të vonohemi sa më shpejtë të vijë një rekomandim për faktin se ne duhet të i kryejmë obligimet tona karshi me këtë organizatë. Sa i përket pikës së dytë, shumica kemi qenë dakord për faktin se është një staf deficitare dhe gabimet janë të natyrshme që sekretariati nuk e ka parapa me kohe koeficientin e parapare për këtë kategori prandaj unë edhe në këshill e kom mbështet këtë propozim. Po ashtu, tha z. Gashi, edhe të pika e tretë për punonjësit e 14 shkurtit në zgjedhje ne jemi të obliguar ata e kanë krye detyrat të cilat ne ju kemi dhënë udhëzimet faktikisht KQZ-ja atëherë kështu që jemi të obliguar të kryejmë këto obligime karshi punëtorëve të cilët i kanë krye punët sipas udhëzimeve tona. Ju faleminderit.

Alim Rama: Unë, si thashë ky shqyrtimi për pagesën në Aweb nuk është dashur të vijë fare në KQZ-ë. Dhe duhet me u transferuar në këshill për mardhanje me jashtë. Sa i përket ndryshime dhe miratimin e koeficientit të zyrtarëve të teknologjisë informative, unë mendoj se proceduralisht është gabim që ky rekomandim të vijë nga këshilli për buxhete dhe financa. Këshilli për buxhete dhe financa, mundet me konstatuar buxhetin por shkalla të grada e caktuar tek këshilli personell, dhe unë nuk mundem me përkrahë sepse, është gabim procedural. Jo që mendoj se ata nuk duhet me u paguar me grade 8, por rekomandimi të vijë nga këshilli i gabuar. Sa i përket pagesave mendoj që të gjitha obligimet që ka marrë KQZ-ja duhet me i krye. Faleminderit...

Arianit Elshani: Kryetare unë e kam një kërkesë me këtë të fundit ku z.Rama pajtohem që është kërkesë në raport me sekretariatun unë e kam parë disa here disa rekomandime të cilët kanë ardhur neper këshilla të ndryshëm realisht nuk ka qenë fare kompetenca e një këshilli dhe kërkoj që të lexohet mirë rregullorja e punës së KQZ-së dhe të respektohet në plotëni,

veçmas ne raport me qeshjet te cila duhet te trajtohen janë decetivishte të shkruara qartë se ku çka shqyrtohet në raporte me stafin e përkohshëm te angazhuar në zgjedhje. Kjo, është kompetencë qartë e shkruar në rregulloren e punës. Nuk ka pasur nevojë me u trajtuar në këshill për buxhete dhe financa, ndoshta pas këshillit për personel, ndoshta një miratime nga këshilli për buxhet që mundet të miratohet... Kemi buxhet, por janë kërkesa të cilat duhet të vijnë nga këshilli për personel...

Florian Dushi: Domosdoshmëritë, kjo pikë duhet me ardhur në këshill te buxhetit për faktin se ka obligime buxhetore dhe është këshilli për buxhet qe ka konstatuar nuk do te thotë qe nuk bene te kthehet ne këshillin e personelit por këshilli për buxhet vetëm se ka konstatuar qe ka buxhet te mjaftueshëm për te rritur këtë koeficient ne qofte se dëshironi te trajtohet pastaj ne këshillin për personel jemi ne rregull si procedurë rritjen e koeficientit paraprakisht, por kjo ka implikime buxhetore dhe duhet patjetër te merret mendimi nga komisioni për buxhet prandaj e ka marr miratimin qe kjo mundet te behet tani për procedura tjera për me vonuar ne edhe mundemi qe te vonojmë por nuk ka asnjë pengese ne qofte se miratohet si e tille.

Kreshnik Radoniqi: E hedh në votime miratimin për ndryshimin të koeficientit për zyrtaret te IT-së ne QNR-ë ?

Miratohet me 8 vota për, 1 kundër (Alim Rama).

Lidhur me pikën e tretë, atë të për pagesën e personave që janë larguar nga lista e pagesave por që kanë qenë të kyçur në procesin e zgjedhjeve parlamentare të 14 shkurtit, u zhvillua një debat i gjerë në të cilin, diskutuan: Arianit Elshani, Burim Ahmetaj, Kreshnik Radoniqi.

Në fund, u miratua edhe kjo pikë e Këshillit të Buxhetit. Florian Dushi, nuk mori pjesë në votim...

3. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut:

Florian Dushi: Këshilli për Çështje Ligjore ka trajtuar dy çështje: E para, ka të bëjë me zëvendësimin e një natareje të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut. Fjala është për

zëvendësimin e zonjës Ksenia Bozheviç, e cila ka dhënë dorëheqje për arsye të emërimit të saj ne një funksion tjetër të ri, me zonjën Habiba Busevac nga subjekti i njëjtë politik e që, është Grajancanca Iniciativa SDP Oliver Ivanovic. Këshilli, ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e këtij rasti të zëvendësimit, duke u kujdesur për implementimin edhe të kërkesave që dalin nga ekzekutimi i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me zëvendësimet e të njëjtës gjini dhe personave me numër më të madh të votave dhe ka ardhë në përfundim që zonja Habiba Busevac të emërohet si anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut.

Miratohet me vota unanime...

Shqyrtimi i miratimi i Udhëzimit Administrativ për Stafin teknik në QV:

Florian Dushi: Faleminderit kryesues, pika e dytë ka të bëjë me miratimin e udhëzimit administrativ nr. 03/2021 për menaxherët dhe stafin teknik të qendrave të votimit. Fjala është për diçka që në të kaluarën është provuar të rregullohet me një udhëzues të thjeshtë e që në këto zgjedhje synohet që kjo të ngritet në një nivel tjetër duke shndërruar atë udhëzues i cili ka pas një karakter pak më të butë do të thoja ne një udhëzim administrativ zbatimi i të cilit pra nuk mund të vihet ne pikëpyetje nga asnjë përgjegjës gjatë procesit të zgjedhjeve. Ndryshimet e këtij udhëzimi përveç statusit të këtij udhëzimi me udhëzuesin që ka qenë më përpara nuk janë shumë të mëdha ka disa çështje të cilat janë rregulluar, ka disa çështje të cilat janë saktësuar p.sh, çështjet që ndërlidhen me stafin teknik, është menduar dhe menaxherët, sidomos me menaxherët është emëruar që kjo përgjegjësi në të ardhmen ti lihet zyrtarit te lartë komunal të zgjedhjeve, duke pasur parasysh se derisa këtë autorizim e kanë pasur komisionet komunale të zgjedhjeve, ka pasur mjaft probleme në zgjedhjen e këtij stafi. Ky staf, natyrisht edhe menaxheri edhe pjesa tjetër e stafit teknik, orientimi i parë do të jetë kah stafi i shkollave të cilat shfrytëzohen si qendra të votimit por megjithatë për shkak se në të kaluarën ka pas raste që i gjithë stafi këtyre shkollave, pra stafi arsimor-teknik kanë refuzu që të marrin këto përgjegjësi, është dashur që të dilet përtej kësaj e të pranohen staf tjetër dhe në të kaluarën kjo ka qenë më atë udhëzues në njëfarë forme jo e lejuar, janë shtuar disa kriterë.

Sa i përket menaxherëve të qendrave të votimit, tha z. Dushi, sidomos është shtuar kriteri sepse është vërejtur që disa nga menaxherët e qendrave të votimit duke qenë drejtor të shkollave

thjeshtë janë përfshirë në fushata elektorale të kandidatëve apo të subjekteve të caktuara politike prandaj është futur si kriter që të njëjtit nuk do të duhej të kenë qenë pjesë aktive e fushatave elektorale të subjekteve ose kandidatëve të caktuar politike pastaj tek qendrat e votimit me numër më të madh se 15 vendvotime për të siguruar një menaxhim më të mirë të qendrës, përveç menaxherit të qendrës të ketë edhe një zëvendës menaxher i cili, do të ndihmonte menaxherin në këto qendra të votimit me numër të madh të vendvotimeve që të menaxhojnë situatën në ditën e zgjedhjeve. Është saktësuar pjesa që ndërlidhet me detyrat e menaxherëve të qendrave të votimit sepse të njëjtit shpeshherë kanë provuar që të luajnë rolin e prororit të këshillave të vendvotimit. Kemi saktësuar edhe brenda këtij udhëzimi administrativ që menaxherët e qendrave të votimit nuk kanë asnjë rol nuk kanë asnjë përgjegjësi dhe nuk mund të interferojnë apo të ndërhyjnë në procesin zgjedhor i cili zhvillohet brenda vendvotimit e për cka absolut përgjegjës është Këshilli i vendvotimit dhe çështje të tjera të ngjashme që ndërlidhen me paraqitjet e tyre në media e gjëra tjera por që megjithatë konsiderojmë që si tërësi ky udhëzim administrativ do të sqarojë jashtëzakonisht shumë rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherëve të qendrave të votimit por edhe pjesës tjetër të stafit teknik brenda atyre qendrave të tjera të votimit, prandaj si Këshill për Çështje Ligjore unanimitisht i rekomandojmë KQZ-së për aprovimin e tij...

Alim Rama: Faleminderit kryesues, unë mendoj që ky udhëzim administrativ është rrjedhimisht kundër atij vendimi që kemi marrur që rregullat e lojës të mos ndërrohen kur fillon loja ky udhëzim administrativ ndikon drejt për drejt në organizimin e zgjedhjeve edhe mendoj që pike se pari unë kam pranuar dhe nuk kam kohë as më trajtuar këto komente. Mendoj që ky udhëzim administrativ pikë së pari në parim, nuk duhet të u trajtuar në procese zgjedhore se dyti unë kam disa vërejtje që edhe nevojitet shumë e me shumë kohë për të trajtuar një udhëzim kaq të rëndësishëm sepse, ky e definon mënyrën e përzgjedhjes ku në parim, krijon një kundërshtim në qoftë se i jepet shumë autonomi zyrtarit komunal të zgjedhjeve. Në parim, edhe pse nuk e kam parë në detaje por, prej atë që e kam lexuar jepet shumë autonomie zyrtarit të lartë komunal në përcaktimin në mënyrën që unë mendoj që udhëzimi administrativ, duhet të krijojë një çelës si bëhet emërimi, kush nga stafi dhe, cili emërohet...Kjo nuk mund të lihet në dorë të një personi...

Florian Dushi: Natyrisht, secili e ka kënd vështrimin e tij por me gjithë atë unë konsideroj qe nga vete pjesa e përgjegjësive te mëngjërve dhe stafit teknikë e qe është thelbi i asaj qe ne e kemi provuar te rregullojmë me këtë udhëzime administrative nënkupton qe po flasim për një kategori te stafit te cilët do te angazhohen ne ditën e zgjedhjeve por qe përgjegjësia e vetme e tyre është mëngjismi teknik i qendrave te votimit sepse te njëjtit nuk e kane as një me te voglin rol dhe përgjegjësi ne organizimin rrjedhën dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhorë ne ditën e zgjedhjeve pra këshillat e vend votimeve mbeten ashtu sic është përcaktuar me ligj si trupa qe kane përgjegjësie e organizimit te zgjedhjeve...Ne, kemi menduar që do të ishte më mirë të rregullohet...

Arianit Elshani: E para konsideroj qe dokumentet e tilla te vine paraprakisht të shqyrtohen nga ne te gjithë anëtarët. Unë, në parim jam për këto ndryshime në qoftë se e kam kuptuar qartazi se menaxheret e qendrave të votimit do të vazhdojnë me proceduarat aktuale të përzgjedhjes së tyre, mirëpo në rastet kur nuk gjinden ata ose refuzojnë ose nuk ka ngadalshmëri për te kryer punën e tije gjate ditës se zgjedhjeve atëherë ndërrohet dhe bartet kjo përgjegjësi tek zyrtari i larte dhe si kryesues i KKZ-së. Ne, nuk mundemi te anashkalojmë faktin që gjatë ditës së zgjedhjeve kemi evidentuar raste kur publikimi i rezultateve është vonuar për shkak të menaxhereve të pa përgjegjshëm për të cilët KQZ-ja nuk mundet të merr masa në raport me ta...Besoj që kjo, do ta lehtësonte punën por, në të njëjtën kohë do ta rriste efikasitetin tonë...

Alim Rama: Unë, para se gjithave, dua me potencuar faktin se ky udhëzues rregullon një çështje shumë të rëndësishme në procesin zgjedhorë. Edhe nuk është dashur me aradhe fare në KQZ-ë gjatë procesit zgjedhor. Këto udhëzime, nuk duhet me u aprovuar në mes të procesit dhe ne kemi pasur edhe vërejtje nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropiane që janë ndërruar disa udhëzime në procesin e fundit zgjedhor gjatë procesit...Unë, nuk mundem me pranuar një dokumente i cili ka 15 faqe, i ka 18 nene, i cili e rregullon një pjese te rëndësishme të procesit zgjedhor...Kjo paraqet shumë problem ky dokument, unë nuk mundem me e votue...

Ilir Gashi: Unë, kam ardhur me vonesë por sa unë e dije është pjese e planit te punës plotësime ndryshime i këtij udhëzimi dhe ne baze te planit te punës është dashur te ndodh ky plotësim ndryshime, në qofte se ka elemente ku nuk jeni dakord atëherë natyrshëm është ardhur për tu diskutuar edhe munde të diskutojmë nen për neni sepse është obligime s' do te thotë ne qofte

se e ka miratimin e këshillit apriori do te duhet me marre bekimin për atë vjen ne KQZ-ë për me u diskutuar edhe me u trajtuar në qofte se ka ndjenjë pa qartësi apo diçka që nuk shkon atëherë, mund të jepen edhe vërejtjet edhe për atë është ardhur këtu...

Në këtë pikë në vazhdim, diskutuan, analizuan dhe dhanë shpjegime e mendime rreth këtij dokumenti: Arianit Elshani, Florian Dushi, Kreshnik Radoniqi, Alim Rama dhe Burim Ahmetaj.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, e përfundojmë këtë diskutime. A po lamë për mbledhjen e radhës, apo doni me votue ? Atëherë, udhëzimin administrative do ta trajtojmë në mbledhjen e radhës pasi që të njoftoheni me leximin e këtij udhëzime administrativ. Atëherë, vazhdojmë me këshillin për personel...

4.Këshilli për Personel

Vlerësimi vjetor i punës dhe i detyrave të Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së dhe ZV të KE-së:

Alim Rama: Sa i parket këshillit për personel, në piken për rekomandimin në lidhje me vlerësimin e këtij pozitës së drejtorit ekzekutive dhe zv, shefit ekzekutive që bëjmë vlerësimin në bazë të rregullores numër nr. 6 /2012, neni 8 për pozitën e lartë të drejtuesit në shërbimin civil të republikës se Kosovës. Për çdo zyrtar të lartë drejtues, vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij ne baza vjetore, sipas nenit 9 paragrafit 1 i kësaj rregullore. Vlerësimet vjetore përfundojnë në përvjetorin e punësimit të zyrtarit të lartë drejtues në pozitën përkatëse...Dhe, ne mendojmë dhe Këshilli ka rekomande që ky vlerësim të bëhet në javën e parë të shtatorit për të dy anëtarët...

Kreshnik Radoniqi: Do të thotë në javën e parë të shtatorit me e bërë vlerësimin e drejtorit të zyrës edhe te zëvendës krye shefit. Pika e gjashtë është hequr...A ka dikush tjetër...?

Florian Dushi: Besoj, e keni vërejte edhe ju sot, do të thotë ka ditë në të cilat edhe ne si anëtarë edhe Sekretariati po ngarkohet jashtëzakonisht shumë me takime të njëpasnjëshme të këshillave prandaj konsideroj që edhe si KQZ por edhe si Sekretariat do të duhej qe planifikimin e takimeve ta bëjmë në një formë e cila do të ishte më e lehtë edhe per Sekretariatin por edhe për anëtarët e këshillave dhe në një formë që thjeshtë të kishim një

distancë nga dita kur do të mbahen këshillat deri në ditën kur mbahet mbledhja e KQZ-së dhe sikur të kemi një planifikim të tillë sigurisht që pastaj nuk do të kontestoheshin sikur rasti i këtij udhëzimi që thjeshtë para dy ore është shqyrtua në Këshill dhe ka ardhë drejtpërdrejte në mbledhje të KQZ-së, prandaj unë ju lus edhe juve si kryesues të filloni plainifikimet me kryesuesit e këshillave për agjendën javore të këshillave të KQZ-së por edhe Sekretariati të planifikojë saktë...

7. Të ndryshme !